ANITA MOORJANI

TË VDESËSH PËR TË GJETUR VETEN

ROMAN

BOTIMET TOENA

The *New York Times* bestseller

ANITA MOORJANI

Të vdesësh për të gjetur VETEN

udhëtimi im nga kanceri te pragvdekja
e deri te **shërimi i vërtetë**

rrëfim autobiografik

Përktheu në shqip Fabiana Papastefani

Me parathënie nga Dr. Wayne W. Dyer

BOTIMET TOENA

Autore: Anita Moorjani
Titulli në origjinal: Dying to be me
Botoi në origjinal anglisht: Hay House Inc., 2022

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi
Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Rogen Alushani

ISBN9789928961105

© 2012, 2022 Anita Moorjani
© *në shqip* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

Denit, dashurisë sime të vërtetë:
Gjithnjë e kam ditur që dashuria jonë shpaloset
përtej kohës dhe hapësirës. Sikur të mos ishte për ty,
unë nuk do të isha në këtë jetë sot.

Nënës sime të dashur dhe ***vëllait tim***
të mrekullueshëm, Anoop:
Faleminderit që më jeni gjendur në çdo moment
të jetës, por sidomos gjatë sëmundjes sime,
si dhe për kujdesin që më keni kushtuar kur kisha
më shumë nevojë. Do të doja që të gjithë të kishin
një familje që të kujdesej për ta,
në mënyrën se si ju u kujdesët për mua.

Në kujtim ***të atit tim*** të dashur,
ëndrra më e madhe e të cilit ishte
që të më shihte nuse, por që u largua nga kjo jetë
para ditës së madhe:
Faleminderit që më dhe mundësinë që të përjetoja
praninë tënde të pafund dhe dashurinë tënde
pa kushte në botën tjetër, si dhe që më dhe sigurinë
që je përherë këtu, atje dhe gjithkund.

Unë besoj se të vërtetat më të mëdha të këtij universi
nuk gjenden atje tutje, në studimet e yjeve
dhe planetëve;

Ato gjenden thellë brenda nesh, në madhështinë
e zemrës, mendjes dhe shpirtit tonë.

Nuk do të mund të kuptojmë atë që shtrihet përtej,
derisa të kuptojmë atë që gjendet brenda nesh.

Po ndaj me ju historinë time,
me shpresën që t'ju prekë zemrën njëfarësoj
dhe t'ju ndërmend madhështinë tuaj.

PARATHËNIE

Jam prekur thellësisht nga përmbajtja e këtij libri, e për më tepër nga marrëdhënia e drejtpërdrejtë me Anita Moorjani-n, e cila hyri në jetën time përmes një sërë rrethanash të orkestruara nga Qielli. Prej më shumë se katër vitesh, një kancer në fazë të avancuar e çoi Anitën deri në prag të vdekjes dhe përtej tij; e futi brenda vetë shtëpisë së vdekjes, shumë përtej derës dhe korridorit, si të thuash. Anita e ka përshkruar të gjithën me shumë hollësi në këtë libër të kërkimit shpirtëror. Ju nxis ta lexoni me shumë kujdes e maturi, me një mendje të hapur ndaj vënies në diskutim të disa prej bindjeve tuaja të çmuara, sidomos atyre mbi atë çka shtrihet përtej kësaj bote, ose mbi atë që shpesh përkufizohet si bota e përtejme.

E rrethuar nga të dashurit e saj dhe nga një ekip mjekësh, në pritje të frymës së saj të fundit nga çasti në çast, Anita dergjej në koma të thellë. E megjithatë, kundër çdo pritshmërie, asaj iu dha mundësia që të rikthehej në trupin e saj të rrëgjuar nga kanceri, dhe përjetoi një shërim të pabesueshëm falë përçimit të një dashurie pa kushte. Për më tepër, asaj iu dha mundësia që të kthehej nga dhoma e vdekjes dhe të

na tregojë të gjithëve se si mund të duket jeta përtej botës fizike, dhe çka është më e rëndësishmja, se si ndihesh në atë botë.

Kjo është një histori dashurie: një histori dashurie e thellë dhe pa kushte që do t'ju dhurojë një ndjesi të ripërtërirë të asaj që jeni në të vërtetë, pse jeni këtu, dhe se si të kapërceni çdo lloj frike apo refuzim të vetvetes që mund të përkufizojë jetën tuaj. Anita flet për kancerin me një çiltërsi të pazakontë, duke shpjeguar pse mendon se gjatë jetës së saj i duhej të përshkonte këtë shteg të vështirë, përse mendon se u shërua, dhe përse u kthye në këtë jetë. Dhe pa lënë shteg për keqkuptime them se misioni i jetës së saj reflektohet në pjesën dërrmuese në faktin që **ju** po bëheni gati të lexoni tregimin e saj mbi këtë përvojë... dhe unë nga ana ime jam i përfshirë kokë e këmbë që ta përhap këtë mesazh thelbësor në gjithë botën.

Ajo që Anita zbuloi gjatë komës së saj 24-orëshe, gjatë së cilës ajo kaloi përmes derës së vdekjes *e në botën e përtejme*, përputhet në mënyrë të habitshme me atë që mua vetë më është përcjellë gjatë momenteve të frymëzuara shkrimi dhe diskutimesh. Ne të dy jemi të vetëdijshëm se hyri në lojë vetë ndërhyrja hyjnore dhe lëvizi "gurët" në mënyrë të tillë që kjo grua që jetonte në anën tjetër të rruzullit, në një kulturë kaq të pangjashme me timen, të futej brenda fushës së vëmendjes dhe të më shfaqej në jetën reale.

Për herë të parë dëgjova për Anitën kur mora një kopje të intervistës mbi përvojën e saj të pranë-vdekjes (NDA), intervistë kjo e bërë nga një grua

në Nju Jork e quajtur Mira Kelley, e cila pastaj u bë mikesha ime dhe më bëri një seancë regresioni në jetët e mëparshme (kjo pjesë është e botuar në librin tim "Plotësimi i dëshirave"). Vetëm me një të lexuar të tregimit të pranë-vdekjes së Anitës ndjeva dëshirën e papërballueshme që të bëja gjithë ç'kisha në dorë për të shpërndarë në të gjithë botën këtë mesazh kaq të fuqishëm. I telefonova Reid Tracy, presidentes së shtëpisë botuese *Hay House*, dhe e nxita që të gjente Anita Moorjanin dhe t'i kërkonte që të shkruante një libër ku të përshkruante me hollësi përvojën e saj të pranë-vdekjes. I shtova se do të kisha kënaqësinë, apo më mirë të them *nderin*, që të shkruaja parathënien e librit të saj, nëse ajo do të kishte dëshirë ta shkruante këtë libër.

Kështu, përmes një sërë veprimesh mrekullisht të sinkronizuara, duke përfshirë telefonatën e Anitës nga Hong Kongu gjatë programit tim në radio të faqes së *hayhouseradio.com* dhe intervistën që i mora Anitës, e dëgjuar në të gjithë planetin, ne u lidhëm qoftë nga ana profesionale, po ashtu dhe personale.

Anita foli mbi kuptimin e asaj që ne të gjithë jemi: dashuri qelibare. Ne jo vetëm që jemi të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe me Zotin, por në një sens më të thellë, ne jemi të gjithë Zoti vetë. Ne kemi lejuar frikërat dhe egon tonë që të shkëpusin Zotin nga jetët tona, gjë që ka shumë të bëjë me shumicën e sëmundjeve jo vetëm të trupit, por të të gjithë botës. Ajo diskutoi se si të mësojmë të ruajmë si thesar të çmuar madhështinë tonë dhe të jetojmë si qenie drite

dhe dashurie, si dhe në lidhje me vetitë shëruese të një mendësie të tillë.

Anita përshkruan përvojën reale të mungesës së kohës dhe hapësirës, duke ndjerë për herë të parë mrekullinë e dijes se tërësia nuk është një koncept intelektual që e mendon me mendje dhe kaq, por që në të vërtetë çdo gjë është duke ndodhur njëherësh. Ajo tregon se si u zhyt e tëra në një brerore dashurie të mirëfilltë, të lumnueshme, dhe se si kjo ndjesi mbart në vetvete mundësi të pakufizuara shërimi. Ajo e mësoi në mënyrë të drejtpërdrejtë kuptimin e vërtetë të frazës së Jezusit në Bibël që thotë: "Për Perëndinë çdo gjë është e mundur (*nga Kapitulli i Mateu 19:26*)" dhe se si kjo fjali nuk lë jashtë *asgjë*, as edhe shërimin e së shkuarës. Anita e zbuloi vetë dhe drejtpërsëdrejti atë që unë kam përshkruar gjerësisht në librin tim "*Dëshirat e plotësuara"*, pra që ligjet e botës fizike (duke përfshirë edhe ato mjekësoret) nuk vlejnë në praninë e vërtetë të Zotit.

Duhej ta takoja këtë grua. Që në fillim të bisedave tona telefonike unë fillova të ndiej drejtpërdrejt esencën shpirtërore të Anitës dhe mesazhin e saj të shpresës që zëvendësonte atë të frikës. E ftova që jo vetëm të shkruante këtë libër, por të dilte me mua në kanalin PBC dhe t'i tregonte gjithë botës historinë e shpresës, dashurisë dhe shërimit të saj.

Ia dërgova intervistën e pranë-vdekjes së Anitës nënës sime 95-vjeçare që jeton në një qendër përkujdesjeje për të moshuarit. Aty nëna ime e sheh shpesh vdekjen me sy, pasi shumë prej miqve të saj

janë të moshuar dhe ata thjesht ndërrojnë jetë në gjumë dhe zhduken nga realiteti i saj përgjithmonë. Kam pasur shpesh biseda me të lidhur me atë që ajo mendonte mbi misterin e madh të quajtur vdekje, që është fati i çdo qenieje të gjallë. Çdo gjë që materializohet, edhe çmaterializohet. Ne këtë e dimë nga një këndvështrim intelektual, e megjithatë ajo që na pret është një mister i madh.

Pasi lexoi raportin e pranë-vdekjes së Anitës, nëna më tha se e pështolli të tërën një valë paqeje, që zuri vendin e ankthit, frikës, stresit në lidhje me atë çka e panjohura e madhe do të sjellë. Në të vërtetë, cilido që lexon përvojën e pranë-vdekjes së Anitës, edhe fëmijët e mi, u ndjenë sikur iu zgjat jeta, dhe m'u betuan që, mbi çdo gjë tjetër, do të kenë dashuri për veten, do të çmojnë madhështinë dhe mrekullinë e tyre dhe që do të largojnë nga jeta e përditshme çdo mendim që ndjell sëmundje. Ndërkohë që unë vetëm shkruaja mbi këto ide, Anita i shprehu për të gjithë në botën e përvojës së vërtetë.

Ajo arriti të shëronte trupin e saj dhe në shumë raste më tha se mendonte që ishte kthyer për të dhënë këtë mësim të thjeshtë por të fuqishëm që ka forcën jo vetëm të të shërojë, por edhe të transformojë gjithë botën tonë. Dhe unë e di shumë mirë që kjo është arsyeja pse Zoti bëri që unë dhe Anita të takoheshim. Gjithmonë e kam ditur që mjeshtëria ime ishte që t'i mësoja njerëzit mbi aspektin e tyre hyjnor dhe se vendi më i shtrenjtë në brendësi të tyre ishte Zoti vetë. Ne nuk jemi trupi që *kemi*, nuk jemi

as arritjet apo pasuritë tona. Ne jemi një me Fillesën e të gjitha qenieve, që është vetë Zoti. Ndërkohë që shkruaja mbi gjithë këto gjëra në librin "*Dëshirat e plotësuara"*, Anita Moorjani hyri në jetën time si për të vendosur një pikë çuditëse mbi gjithë çka po merrja gjatë procesit të të shkruarit automatik në gjendje meditative. Ajo e jetoi vetë dhe e tha kaq bukur. Dhe tani edhe ju jeni të bekuar, keni mundësinë ta lexoni vetë dhe të vini në jetë atë që Anita mësoi gjatë luftës së saj të furishme ndaj një kanceri në fazë të avancuar, dhe gjatë rrugëtimit të saj të qetë në kthim në këtë botë, përmes përvojës së drejtpërdrejtë të shërimit Hyjnor.

Jam i nderuar që të luaj një rol të vogël në përhapjen e këtij mesazhi shprese dhe dashurie, që është edhe shërimi përfundimtar. Uroj që të ndiqni fjalën e Anitës, ta bëni mjet të shkuljes së çdo sëmundjeje nga trupi, nga marrëdhëniet tuaja, nga vendi ku jetoni dhe pse jo, nga e gjithë bota. Siç e tha një herë edhe Elizabeth Barrett Browning në mënyrë kaq poetike:

"Toka gëlon nga Parajsa. Kjo Botë ka kaq shumë parajsë në të, dhe çdo shkurre mali digjet me flakë Perëndie". Dhe vërtet, shërimi dhe parajsa mbi Tokë janë të gjitha për ju që t'i shijoni e gëzoni.

Shijoni këtë libër librin kaq të mrekullueshëm të Anitës. Unë e adhuroj, dhe adhuroj edhe Anitën.

— Dr. Wayne W. Dyer
Maui, Hawaii

HYRJE

Qëllimi kryesor pse po e ndaj historinë time me ju është që të tjerët të mos kalojnë përmes asaj që kalova unë. Nuk e kam zakon që t'u jap mend njerëzve apo t'u them se si të jetojnë jetën e tyre, e as nuk më pëlqen të këshilloj njeri në lidhje me çfarë ndryshimesh duhet të bëjë, edhe sikur të më pyesnin. Parapëlqej që të paraprij me shembuj dhe të krijoj një mjedis të sigurt ku të tjerët mund të hyjnë në kontakt me të vërtetën e tyre.

Kam menduar shpesh për këtë, që prej ngjarjeve të dimrit dhe pranverës së vitit 2006, kur unë pata përvojën e pranë-vdekjes (NDE) dhe prej aty, u shërova nga një kancer që më mundonte prej katër vitesh. Gjatë pranë-vdekjes, pata mundësinë të shoh e të ndiej disa aspekte të jetës sime të ardhshme dhe e kuptova që një prej arsyeve pse zgjodha që të kthehesha në jetën tokësore ishte sepse përvoja dhe mesazhi im do të prekte njerëz të tjerë.

Në gjendjen ku isha, në një farë mënyre e dija se isha e prirë që të frymëzoja me mijëra persona, ndoshta dhjetëra mijëra. Por nuk e kisha të qartë se si do arrija ta bëja këtë. Thjeshtë e dija që në një farë mënyre do

të arrija të ndihmoja plot njerëz të tjerë. Në veçanti, pata ndjesinë që nuk duhej të bëja asgjë të veçantë që kjo të ndodhte. Duhej vetëm të isha vetvetja, të shijoja jetën dhe të lejoja që të bëhesha instrument për diçka më të madhe që do të shpalosej. Dhe në fakt kështu rrodhën gjërat, sepse arrita që të flas e të shkruaj mbi përvojat e mia, si përgjigje të hulumtimeve që vinin nga fushat e mjekësisë dhe shkencës, si dhe të shumë personave që kërkonin përgjigje mbi natyrën e botës së tyre dhe mbi përvojat vetjake.

Dhe kështu lindi edhe ky libër (ato detaje do t'i lexosh në Kapitullin 14). Unë shpjegoj pa rezerva atë që mësova si rezultat i kancerit dhe përjetimit të pranë-vdekjes sime. Më pëlqen ta ndaj këtë përvojë dhe kuptimin që nxora për jetën pas asaj përvoje, sidomos kur ndiej se të tjerët mund të përfitojnë sado pak nga kjo.

Historia ime fillon në **Pjesën I**, ku unë nis e tregoj se si u rrita në mes të një udhëkryqi kulturash që mbanin brenda tyre besime shumë të ndryshme dhe ndonjëherë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Do ju tregoj se si e gjithë kjo më formoi dhe më nguliti frikëra të ndryshme, që më vonë u manifestuan si sëmundje në trupin tim, duke ju marrë me vete në rrugëtimin tim drejtë moshës madhore, dhe rënien në ferrin e kancerit.

Pjesa II hyn në brendësi të vetë pranë-vdekjes: çfarë pashë dhe kuptova në ato momente dhe çfarë ndodhi pas saj. Shërimi nga kanceri dhe përpjekjet e mia për të gjetur tashmë një vend të ri në këtë botë

kanë qenë një rrugëtim me sfida, që më ka habitur por edhe mrekulluar.

Në **Pjesën III** përshkruaj atë që unë tashmë kuptoj mbi shërimin, kuptoj botën ashtu siç është sot dhe se si mund të jetojmë në pasqyrim të asaj që me të vërtetë jemi, duke lejuar që të ndriçojë madhështia dhe mrekullia jonë. Pastaj e mbyll me pyetje e përgjigje, që përmbajnë shqetësimet më të shpeshta e të zakonta që dëgjoj nga publiku. Por para se të ndaj me ju atë që kam mësuar nga përvoja ime, dua të sqaroj që nuk them se njoh të vërtetat universale apo shkencore, apo që të bëhem guru shpirtëror i dikujt. As nuk kam ndërmend të nis një religjion apo sistem besimi të ri. Unë dua thjesht të *ndihmoj* dhe jo të *mbush mendjet* e njerëzve.

Unë dua sidomos të nënvizoj faktin se nuk të duhet të kalosh përmes një pranë-vdekjeje në mënyrë që të shërohesh. Synimi im është që të ndaj me ju të gjithë faktorët nxitës emocionalë dhe psikologjikë që besoj se ndikuan të sëmuresha me kancer, me shpresën që duke identifikuar këta faktorë, ju të arrini të ulni në minimum çdo mundësi që trupi juaj të sëmuret, dhe pse jo, të mënjanoni fare këtë shans. Nga ana tjetër, nëse ju apo dikush që njihni ka kancer apo ndonjë sëmundje tjetër të rëndë, ju lutem kini parasysh se ekzistojnë shumë rrugë drejt shërimit. Unë do ju sugjeroja që të ndiqni atë që zemra juaj ndien si rrugë të drejtë dhe që i qaset personalitetit tuaj.

Nëse prisni që t'ju jap udhëzime hap pas hapi apo ndonjë doktrinë për të ndjekur, atëherë nuk jam

personi i duhur për ju, pasi nuk besoj në një dogmë që të mund "t'i vishet" çdo lloj trupi e njeriu. Kjo veç sa do të kufizonte atë çka ju jeni. Edhe kur flas për dashurinë që kam për veten, synimi im nuk është që të tërheq vëmendjen mbi mua, por që ju vetë të provoni atë ndjesi brenda qenies suaj. Duke ndarë me ju përvojën time dhe atë çka kam kuptuar, qëllimi im i vetëm është që të ndez shkëndijën e madhështisë që shtrihet brenda jush. Dëshira ime është që të rizgjoj guru-në që fle brenda jush, që ju drejton ta gjeni vendin që iu përket në qendër të universit.

Uroj që të gjeni gëzim në çdo ditë të rrugëtimit tuaj dhe të arrini të bini në dashuri me jetën, siç po bëj edhe unë tani!

PJESA I
NË KËRKIM TË RRUGËS SË DREJTË

PROLOG

DITA KUR "VDIQA"

O Zot, sa mirë që ndihem! Jam kaq e lirë dhe e lehtë! Si ka mundësi që nuk ndiej më dhimbje në asnjë pjesë të trupit? Ku shkuan të gjitha? Dale, pse po më duket sikur sendet po shtyhen tutje, duke u larguar nga unë? Ama, nuk kam frikë! Si ka mundësi që nuk kam frikë? Ku u zhduk frika ime? Oh, uau, s'ka asnjë gjurmë frike tanimë!

Këto mendime më vërtiteshin nëpër kokë ndërkohë që më çonin me urgjencë për në spital. Bota rreth meje filloi të dukej surreale dhe dramatike, dhe ndieja që po rrëshqisja përherë e më tutje, larg gjendjes së vetëdijshme, thellë e më thellë në koma. Organet e mia filluan të fiknin funksionet e tyre teksa lëshohesha në krahët e kancerit që kishte shkatërruar - jo, gllabëruar e gëlltitur, trupin tim gjatë këtyre katër viteve të fundit.

Ishte 2 shkurti i vitit 2006, një ditë që do të më skalitej në kujtesë përgjithmonë si dita kur unë "vdiqa". Edhe pse isha në gjendje kome, shihja dhe

ndieja me shumë saktësi gjithçka që po ndodhte rrotull meje, duke përfshirë edhe ndjesinë e urgjencës dhe furinë emocionale të familjes sime, teksa më sillnin me urgjencë në spital. Kur arritëm, fytyra e mjekes onkologe që më pa ndryshoi ngjyrë dhe u kaplua nga një gjendje shoku.

"Zemra e bashkëshortes suaj ndoshta rreh akoma, i tha ajo tim shoqi, Denit, - por në të vërtetë ajo nuk është këtu. Është tepër vonë për ta shpëtuar."

Po për kë e ka fjalën doktoresha? - thashë me vete. *Unë s'e kam ndier veten ndonjëherë më mirë se sot! Dhe pse vallë mami dhe Deni duken kaq të shqetësuar dhe të trembur? Mami, të lutem mos qaj. Çfarë ka ndodhur, xhanëm? Po qan për mua? Mos qaj! Jam mirë, mami, e kam me të vërtetë, o ma, o zemër, të betohem!* Isha e sigurt që ato fjalë po i thosha me zë, por asgjë nuk pipëtiu. Nuk kisha më zë.

Doja ta përqafoja mamanë time, ta qetësoja dhe t'i thosha që isha mirë, dhe nuk e kuptoja pse nuk e bëja dot këtë. Pse trupi nuk më bindej? Pse rrija e shtrirë aty, e pa lëvizur dhe si pa jetë, kur gjithë çka doja ishte që të përqafoja bashkëshortin tim të dashur dhe nënën time të dashur, t'i siguroja që isha mirë dhe se asgjë nuk më dhimbte më?

Deni, shiko! Mund të lëviz pa karrigen me rrota. Oh, ç'mrekulli! Dhe nuk jam e lidhur më as me bombolën e oksigjenit. Oh, uau, nuk e kam më të vështirë të marr frymë dhe plagët në lëkurë më janë zhdukur. As më kullojnë e as më dhembin më. Pas katër vitesh agonie, më në fund jam shëruar!

Isha në një gjendje feste dhe ngazëllimi të plotë. Më në fund isha e lirë nga dhimbjet e shkaktuara nga kanceri që më kishte rrënuar trupin. Doja që edhe ata të ishin të lumtur për mua. Po pse nuk ishin edhe ata të lumtur që vuajtjet e mia më në fund kishin mbaruar, që vuajtja e tyre më në fund mori fund? Pse nuk festonin me mua? A nuk e shihnin gëzimin që më kishte kapluar? "Ju lutem, duhet të ketë diçka që mund të bëni për ta shpëtuar" po u luteshin Deni dhe mami doktorëve.

"Është vetëm çështje orësh për të tashmë, - vijoi me ton të dorëzuar onkologia. - Po pse nuk na e sollën më herët mjekët e tjerë ku e keni vizituar? Organet po i fiken tashmë, dhe prandaj ra në gjendje kome. As natën nuk do të arrijë ta kalojë. Po më kërkoni të pamundurën. Çfarëdo mjekimi që t'i japim në këtë gjendje mund të bëhet toksik dhe fatal për trupin e saj, pasi organet nuk i funksionojnë fare!"

"Dakord, ndoshta - nguli këmbë Deni, - por unë nuk dorëzohem, nuk e lë që të ikë kështu!" Im shoq më kapi dorën që tashmë ishte vetëm një gjymtyrë, teksa dergjesha në atë shtrat, dhe isha e ndërgjegjshme për gjithë përzierjen e angështisë dhe pafuqisë që ndieja në zërin e tij. Mbi çdo gjë tjetër, doja kaq shumë ta çliroja nga ajo vuajtje. Doja që ai të dinte se sa mrekullisht po ndihesha, por isha shumë e pafuqishme për ta bërë këtë.

Mos e dëgjo doktoreshën, Deni, të lutem mos ia vër veshin asaj. Pse thotë këto gjëra ajo? Unë jam

ende këtu dhe jam mirë. Ç'them mirë, shumë më mirë se "mirë". Në të vërtetë unë ndihem shkëlqyer!

Nuk e kuptoja se pse, por në ato momente po përjetoja gjithë ndjenjat që secili po përjetonte, si familja ime, ashtu edhe doktoresha. Në fakt, ndieja frikën në zemrën e tyre, ankthin, pafuqinë dhe dëshpërimin. Ishte sikur gjithë ato emocione të ishin të miat, ishte sikur unë u bëra ata.

Oh, i dashur, ndiej dhimbjen tënde, ndiej emocionet e tua. Të lutem mos qaj për mua dhe i thuaj edhe mamit që të mos qajë për mua. Të lutem thuaji!

Por sapo fillova të lidhesha emocionalisht me dramën që po ndodhte rrotull meje, në të njëjtën kohë ndjeva të më tërhiqnin duke më largua prej aty, sikur të më tregohej një panoramë e gjerë, një plan më i madh që po shpalosej dalëngadalë. Lidhja ime me ç'po ndodhte dhe gjithë skenën aty rrotull po dobësohej dhe fillova të kuptoj se çdo gjë ishte e përsosur dhe po shkonte sipas planit në skenën e madhe të universit. Ishte pikërisht në këtë moment që kuptova se në të vërtetë unë po rrëshqisja në krahët e vdekjes.

Ohh... jam duke vdekur! Pra kështu qenka të vdesësh? Nuk e kisha menduar fare kështu! Ndihem kaq mrekullisht në paqe dhe e qetë... dhe ndihem e shëruar më në fund!

Pastaj kuptova se edhe pse trupi im fizik ishte fikur, çdo gjë ende ishte në përsosmëri në hapësirën e madhe të jetës, pasi ne nuk vdesim kurrë. Isha ende tejet e pranishme në çdo hollësi që më shpalosej para

syve, teksa vëzhgoja ekipin e doktorëve që çonin me krevat me rrota trupin tim pothuaj pa jetë në repartin e kujdesit intensiv. Po më rrethonin me një furi emocionale, duke më lidhur me makineritë, teksa më shponin e më ngulnin ago e tuba gjithandej.

Nuk ndieja më lidhje me trupin tim pa ndjenja, teksa dergjej në atë shtrat spitali. As nuk ndieja se ai trup aty ishte i imi. Më dukej shumë më i vogël dhe i pakuptimtë për të strehuar atë që po ndieja në këto momente. Ndihem e lirë, e çliruar dhe shkëlqyer! Çdo dhimbje, shqetësim, trishtim, dhe pikëllim ishte larguar për fare. Isha tërësisht e çliruar nga pesha e çdo gjëje të tillë, dhe as që më kujtohet se kur jam ndjerë ndonjëherë kështu. Asnjëherë!

Më pas fillova të ndjehesha e rrethuar nga diçka që mund ta përshkruaj vetëm si një dashuri e qashtër, pa kufi e kushte, por as këto fjalë nuk më ndihmojnë sado pak ta përshkruaj siç duhet këtë ndjesi. Ishte përkujdesja më e thellë që kisha ndjerë ndonjëherë. Ishte përtej çdo lloj forme fizike të afeksionit që ne mund të përpiqemi të imagjinojmë dhe ishte e pakushtëzuar. Ishte e tëra e imja, pavarësisht nga ajo që mund të kisha bërë ose jo. Mua nuk m'u kërkua që të bëja asgjë, apo të sillesha në ndonjë mënyrë të caktuar që të meritoja tërë këtë përkujdesje. Kjo dashuri ishte e tëra e imja, pavarësisht çdo gjëje!

U ndjeva e tëra e zhytur në këtë energji, dhe më bëri të ndjehesha si t'i përkisja atij vendi, sikur më së fundmi të kisha arritur pas kaq shumë vitesh

vështirësish, dhimbjesh, ankthi dhe frike. Më së fundi kisha arritur në vendin tim, në shtëpi.